

AASF mbështetet nga BERZH dhe Qeveria e Shqipërisë



STUDIM PËR SEKTORIN E AGRUMEVE

Ky studim informon institucionet financiare dhe palë të tjera të interesuara për mbështetjen e sektorit të agrumeve, mbi mundësitë kryesore për të financuar këtë sektor.

STUDIM PËR SEKTORIN E AGRUMEVE

Përgatitur nga:

Programi i Mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar (AASF)

Prof. Dr. Engjëll Skreli / Prof. Assoc. Dr. Drini Imami

Instituti i Studimeve Ekonomike dhe Transferimit të Njohurive

Tiranë, 2019

AASF Project Office
Rr. Andon Zako Çajupi, No. 7
Tiranë, Albania
Tel: +355 69 294 1513
www.aasf.com.al
Info@aasf.com.al

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
1. HYRJE	7
2. METODOLOGJIA.....	9
3. TENDENCAT DHE PRESPEKTIVAT E SEKTORIT TË AGRUMEVE	11
3.1. Prodhimi parësor.....	11
3.2. Tendencat e tregtisë ndërkombëtare.....	14
3.3. Tregu.....	18
4. STRUKTURA E ZINXHIRIT TË VLERËS DHE AKTORËT KRYESORË	21
4.1. Struktura e zinxhirit të vlerës dhe profili i aktorëve	21
4.2. Flukset në zinxhirin të vlerës dhe koordinimi i këtij zinxhiri.....	23
5. PROCESET E TEKNOLOGJISË SË PRODHIMIT	24
6. ANALIZA SWOT DHE NEVOJAT PËR FINANCIM.....	25
6.1. Strategjia bazuar për analizën SWOT	25
6.2. Nevojat për financim	25
7. PËRFUNDIME.....	29
8. REFERENCA	30
9. SHTOJCAT.....	31

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Prodhimi i agrumeve sipas llojeve në vitin 2016 (tonë dhe %)	11
Figura 2: Shpërndarja e prodhimit të agrumeve sipas qarkut (2016).....	13
Figura 3: Dinamikat e importit të portokajve në Shqipëri.....	14
Figura 4: Dinamikat e importit të mandarinave në Shqipëri.....	15
Figura 5: Dinamikat e eksportit të mandarinave nga Shqipëria.....	15
Figura 6: Importi mujor i mandarinave në Shqipëri në vitin 2016 (tonë).....	17
Figura 7: Harta e zinxhirit të vlerës së mandarinave	21

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Tendencat e prodhimit të portokallit në Shqipëri.....	11
Tabela 2: Tendencat e prodhimit të limonit në Shqipëri.....	12
Tabela 3: Tendencat e prodhimit të mandarinës në Shqipëri	12
Tabela 4: Tendencat e prodhimit të mandarinës në botë (000 tonë).....	12
Tabela 5: Tendencat e rendimentit të mandarinës në botë (Tonë/Ha)	13
Tabela 6: Shpërndarja e prodhimit të agrumeve nëpër qarqe sipas llojit (2016).....	14
Tabela 7: Totali i importit dhe eksportit të agrumeve nga Shqipëria (HS 0805).....	16
Tabela 8: Bilanci tregtar i mandarinave në Shqipëri–HS 080520	16
Tabela 9: Importi dhe eksporti i portokajve nga Shqipëria	16
Tabela 10: Importi dhe eksporti i limonëve nga Shqipëria	17
Tabela 11: Eksportet e agrumeve sipas shtetit partner, 2017	17
Tabela 12: Importet e agrumeve sipas vendeve, 2017	18
Tabela 12: Performanca e eksportit të agrumeve	18
Tabela 14: Bilanci i ofertës së mandarinave në Shqipëri (000 tonë).....	19
Tabela 15: Konsumi i portokajve dhe mandarinave në Shqipëri dhe në vende dhe rajone të tjera (Kg/frymë).....	19
Tabela 16: Fermat e mandarinave me orientim tregu, për 2017	22
Tabela 17: Kalendari i kostos së prodhimit të mandarinës	24
Tabela 18: Kalendari i vjeljes sipas llojit të produktit.....	24
Tabela 19: Sektori i mandarinës: Strategjia për analizën SWOT	25
Tabela 20: Nevojat e financimit për investime në sektorin e mandarinës.....	26
Tabela 21: Harta e rajonalizimit të skemave kombëtare të subvencionimit (2018).....	31

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Shqipëria ka një traditë të konsoliduar në prodhimin e agrumeve (përkatësisht portokalle, limona dhe mandarina), prodhimi i të cilave është i përqendruar në zonat bregdetare. Rritjen më të madhe e kanë shënuar mandarinat, produkti më dominues i agrumeve (përbën 2/3 e sasisë së prodhimit të agrumeve). Prodhimi i mandarinave është rritur ndjeshëm këto vitet e fundit: nga më pak se 100 Ha ose më pak se 1000 tonë në vitin 2005, në 26 000 tonë në vitin 2016 dhe mbi 30 000 në vitin 2017 – dhe ndiqet pothuajse me të njëjtin trend rritës nga prodhimi i limonëve dhe portokajve. Si rezultat, importi i mandarinave është karakterizuar nga një tkurrje e fortë si pasojë e rritjes së prodhimit vendas (që ka kontribuar pjesërisht në zëvendësimin e importeve). Gjithashtu, rritje të konsiderueshme gjatë viteve të fundit ka pasur dhe eksporti i tyre.

Objekti i këtij studimi është që të japë një panoramë të përgjithshme të sektorit të agrumeve në Shqipëri, duke u fokusuar te mandarinat, duke analizuar zhvillimet e fundit dhe gjendjen aktuale, dhe duke përfshirë mundësitë, kufizimet dhe vështirësitë, me fokus të veçantë në nevojat/potencialet për investime. Ky raport studimor ofron informacione dhe rekomandime që mund të jenë të dobishme për të orientuar strategjitë e hyrjes (ndërhyrjeve) për institucionet financiare ose për përgatitjen e produkteve e shërbimeve financiare. Por përdorues potencialë të gjetjeve dhe rekomandimeve të këtij studimi mund të jenë edhe institucionet shtetërore, shoqatat e biznesit, agjencitë e zhvillimit, akademikët dhe aktorë të tjerë të interesuar.

Ky studim është përgatitur nga ekspertët e Programit të Mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar (AASF), i cili është një program i financuar dhe zhvilluar nga BERZH (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim) në bashkëpunim dhe me mbështetje nga qeveria shqiptare, i cili ka nisur aktivitetin në vitin 2016.

Qëllimi i këtij Programi është të motivojë institucionet financiare shqiptare për të mbështetur një sektor vital të ekonomisë shqiptare me potenciale gjerësisht të pashfrytëzuara - bujqësia dhe agrobiznesi. AASF siguron qasje në financa për sektorin e agrobiznesit në dy mënyra: Linjë kredish dhe/ose shpërndarja e riskut të portofolit për institucionet mikrofinanciare (IMF) dhe bankat. Institucionet përfitojnë nga një mbulim i parë i rrezikut të humbjeve që u vu në dispozicion nga Qeveria Shqiptare. AASF përfaqëson një instrument inovativ financiar për të inkurajuar kreditimin nga institucionet financiare në të gjithë zinxhirin e vlerës së agrobiznesit.

Përfituesit përfundimtarë të AASF janë fermerët, sipërmarrësit dhe kompanitë që janë të angazhuar në prodhimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore, prodhimin dhe tregtinë e pajisjeve bujqësore, logjistikën, ofruesit e shërbimeve të agrobiznesit, tregtarët me shumicë dhe pakicë. Agrobizneset mund të përfitojnë gjithashtu nga programi i Këshillit të BERZH-it për Biznesin e Vogël, i cili ofron konsulencë për zhvillimin e strategjisë, marketingut, ristrukturimin teknik dhe fushat tjera të zhvillimit institucional nga ekspertët ndërkombëtarë dhe lokalë.

Për arritjen e objektivave të studimit janë të dhëna dhe informacion nga burime dytësore dhe parësore; intervistat gjysmë të strukturuar me aktorë të zinxhirit të vlerës dhe ekspertë të sektorit janë përdorur si burim parësor për mbledhjen e të dhënave. Të dhënat janë analizuar duke përdorur teknika të ndryshme, ku përfshihen analiza përshkruese, analiza e trendeve (dinamike), analiza e tekstit, strategjia bazuar në analizën SWOT. Kombinimi i analizës cilësore dhe sasore ka qenë thelbësor për të identifikuar/kuptuar tendencat, boshllëqet dhe nevojat për investime.

Ky studim informon institucionet financiare dhe palë të tjera të interesuara për mundësitë kryesore për të financuar në këtë sektor. Në nivelin e fermerit, investimet që mund të merren në konsideratë janë mbjellja e agrumeve/mandarinave duke përdorur kultivarë të kërkuar në treg, veçanërisht në tregun e eksportit, duke zbatuar projekte të plota investimesh (mbjellje, sistem ujitjeje me pika/plehërimi dhe investime të tjera përkatëse). Në nivelin e konsoliduesve/shitësve me shumicë, institucionet financiare mund të marrin në konsideratë mbështetjen për ambientet e magazinimit; me shumë gjasë kjo është nevojë më e ngutshme për investim. Ndonëse ruajtja në kushte frigoriferike nuk konsiderohet një nevojë e ngutshme investimi, ekspertët mbështetnin mendimin se në rastin e agrumeve/mandarinave ajo është e domosdoshme. Mandarinat mund të ruhen nga katër deri në gjashtë javë. Investimet në kapacitete magazinuese dhe ambalazhimi përbëjnë gjithashtu një mundësi të mirëfilltë financimi për institucionet financiare. Konsoliduesit me orientim eksporti në zonën e Konispolit dhe shitësit me shumicë po planifikojnë të investojnë në magazina ambalazhimi (linja seleksionimi, klasifikimi dhe paketimi). Kjo është veçanërisht e nevojshme në rastet kur synohet të arrihen segmente më tërheqës të tregut të eksportit, që edhe ofrojnë me çmime më të larta.

Gjithashtu, ekziston nevojë për financime afatshkurtra në likuiditet. Ekziston një diferencë kohore ndërmjet momentit që kryhen shpenzimet dhe shitjet, si në nivelin e tregtarit, ashtu edhe në nivel fermeri. Për këtë arsye, ekziston një kende kohor për kredi afatshkurtra për tregtarët dhe fermerët, të cilat mund të mbulojnë nga bankat.

Sektori i agrumeve konsiderohet si sektor me përparësi për qeverinë shqiptare - sektori është përfshirë në skemat e mbështetjes financiare publike. Politika e granteve të pjesëshme ka implikime të rëndësishme për institucionet financiare - ata kanë mundësinë për të financuar investimet për investimin e 100% të shumës, nga e cila 50% mund të jetë kredi afatshkurtër (pjesa që duhet të rimbursohet nga granti pas përfundimit të investimit) dhe 50% kredi afatgjatë (pjesa që duhet të paguhet nga përfituesi).

1. HYRJE

Bujqësia është një nga sektorët kryesorë të ekonomisë shqiptare për sa i përket punësimit dhe kontributit në PBB dhe konsiderohet si sektor me përparësi nga qeveria shqiptare. Pavarësisht rritjes gjatë kohëve të fundit, bujqësia shqiptare ende përballet me sfida të ndryshme, duke përfshirë vështirësinë në aksesin në kredi; sektori bujqësor ka thithur vetëm 2% të totalit të kreditimit të ekonomisë.

Shqipëria ka një traditë të konsoliduar në prodhimin e agrumeve (përkatësisht portokall, limon dhe mandarinë), prodhimi i të cilave është i përqendruar në zonat bregdetare. Produkti më dominues i agrumeve është mandarina (duke përbërë rreth 2/3 e sasisë së prodhimit të agrumeve) - ajo është agrumja që ka shënuar rritjen më të lartë. Prodhimi i mandarinave është rritur ndjeshëm këto vitet e fundit: nga më pak se 100 Ha ose më pak se 1000 tonë në vitin 2005, në 26 000 tonë në vitin 2016 dhe mbi 30 000 në vitin 2017- dhe ndiqet pothuajse me të njëjtin trend rritës nga prodhimi i limonëve dhe portokajve. Si rezultat, importi i mandarinave është karakterizuar nga një tkurrje e fortë si pasojë e rritjes së prodhimit vendas (që ka kontribuar pjesërisht në zëvendësimin e importeve). Gjithashtu, rritje të konsiderueshme gjatë viteve të fundit ka pasur dhe eksporti i tyre.

Objektivat e studimit

Objekti i përgjithshëm i këtij studimi është që të japë një panoramë të përgjithshme të zinxhirit të përzgjedhur të vlerës në Shqipëri duke analizuar zhvillimet e fundit dhe gjendjen aktuale, dhe duke përfshirë mundësitë, kufizimet dhe vështirësitë, me fokus të veçantë në nevojat/potencialet për investime.

Në mënyrë më specifike, studimi: (i) ofron një panoramë të përgjithshme të prirjeve kryesore të prodhimit, tendencave të tregut dhe tregtisë ndërkombëtare; (ii) - ofron një "vështrim të shpejtë" të strukturës së zinxhirit të vlerës, të flukseve dhe administrimit të zinxhirit të vlerës, me fokus të veçantë të "liderët në zinxhirin e vlerës"; (iii) analizon pikat kryesore të zinxhirit të vlerës nëpërmjet një strategjie për analizën SWOT, dhe (iv) ofron rekomandime për mundësitë kryesore për sistemin bankar (financim për investime, financim për kapital qarkullues dhe financim të zinxhirit të vlerës).

Ky raport studimor ofron informacione dhe rekomandime që mund të jenë të dobishme për të orientuar strategjitë e hyrjes (ndërhyrjeve) për institucionet financiare ose për përgatitjen e shërbimeve financiare.

Metodologjia

Për të përmbushur objektivat e studimit janë përdorur burimet dytësore dhe parësore të informacionit/të dhënave; intervistat gjysmë të strukturuar me aktorë të zinxhirit të vlerës dhe ekspertë të sektorit janë përdorur si burim parësor për mbledhjen e të dhënave. Të dhënat janë analizuar duke përdorur teknika të ndryshme, ku përfshihen analiza përshkruese, analiza e trendeve (dinamike), analiza e tekstit, strategjia bazuar në analizën SWOT. Analiza e zinxhirit të vlerës është përdorur si kornizë e përgjithshme për analizën. Metodologjia përshkruhet më në detaje në seksionin në vijim.

Përdoruesit e synuar

Studimi për zinxhirin e vlerës është hartuar kryesisht për institucionet financiare, por ky raport studimor mund të shërbejë si mbështetje e dobishme në procesin vendimmarrës të aktorëve të tjerë, si Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), agjencitë e zhvillimit dhe aktorët e sektorit privat (p.sh. firmat, shoqatat).

Çfarë është dhe çfarë nuk është ky studim

Studimi është një vlerësim i shpejtë dhe, duke marrë në konsideratë burimet dhe kohën e kufizuar në dispozicion, ai trajton në veçanti nevojën për financim në zinxhirin e vlerës dhe për rrjedhojë mundësitë për financime nga bankierët. Studimi është projektuar në mënyrë të tillë që të jetë i lehtë për t'u lexuar, për sa i përket strukturës/rrjedhës logjike dhe nivelit të hollësive të informacionit, duke iu përshtatur nevojave të vendimmarrësve që e lexojnë (p.sh. bankierët). Studimi është projektuar për të shërbyer si "instrument" për stafin ekzekutiv (të bankave) dhe jo si studim kërkimor në vetvete.

Studimi nuk është një studim i plotë i sektorit apo një studim i zinxhirit të vlerës që në mënyrë tipike ofron një analizë të detajuar të aktorëve në zinxhirin e vlerës, të shërbimeve mbështetëse (shërbimet e biznesit, shërbimet bankare dhe shërbime të tjera ose shërbime të integruara) dhe mjedisin ekonomik global, kombëtar dhe lokal.

Struktura e raportit

Raporti është strukturuar si më poshtë: seksioni i dytë përmban përshkrimin e metodologjisë. Seksioni i tretë paraqet një analizë të gjerë të tendencave të prodhimit dhe të tregtisë ndërkombëtare. Seksioni katër përshkruan strukturën e zinxhirit të vlerës, flukset dhe profilin e aktorëve. Seksioni pesë jep një panoramë të përgjithshme të proceseve të teknologjisë së prodhimit për ta njohur lexuesin me proceset kryesore teknologjike dhe kostot përkatëse, duke theksuar kohën kur kryhen këto procese (që shpesh reflektohen në shpenzime), si dhe kohën e prodhimit (si tregues për kohën e shitjeve). Seksioni gjashtë paraqet analizën SWOT që fokusohet në nevojat/potencialet për investime, ndërsa seksioni i fundit përmban përfundimet.

2. METODOLOGJIA

Përzgjedhja e sektorit

Studimi për zinxhirin e vlerës së agrumeve/mandarinave është pjesë e një "pakete studimesh sektoriale" për sektorët më të rëndësishëm të bujqësisë shqiptare. Për këtë arsye, faza e parë ka konsistuar në përcaktimin e përparësisë së sektorëve ose nënsektorëve apo (grupeve të) produkteve për të cilat ekziston kërkesa/potenciali më i lartë për rritje dhe investime - duke marrë në konsideratë potencialin e tregut për eksport ose potencialin për zëvendësimin e importeve. Dy grupe faktorësh janë marrë në konsideratë gjatë hartimit të listës së produkteve që do të analizoheshin, përkatësisht potenciali i tregut dhe faktorët e tjerë që mundësojnë avantazhe konkurruese të produktit. Potenciali i tregut është shqyrtuar nga dy këndvështrime: potenciali për eksport dhe potencialet për zëvendësimin e importeve. Potenciali për eksport merr në konsideratë performancën e shfaqur të eksporteve (trendin faktik të eksporteve) të kombinuar me kërkesën ndërkombëtare për një produkt të caktuar - kur eksportet rriten në kohë dhe kjo përkon me rritjen e kërkesës ndërkombëtare, konsiderohet se ky produkt ka potenciale për eksport. Potencialet për zëvendësimin e importeve shqyrtojnë potencialet për të përmbushur kërkesën vendase. Aspekte të tjera që çojnë në një avantazh konkurrues përfshijnë faktorin e anës së ofertës, si raportipune-tokë, tradita dhe aftësitë, si dhe lidhjet e vendosura ndërmjet aktorëve në zinxhirin e vlerës, duke përfshirë gjithashtu lidhjet shumë të mira ndërmjet aktorëve shqiptarë dhe blerësve ndërkombëtarë.

Zinxhiri i vlerës së agrumeve/mandarinave konsiderohet si sektor me përparësi duke pasur parasysh potencialin e tyre për eksport.

Fokusi i këtij raporti për zinxhirin e vlerës është te mandarinat, por jepen informacione edhe për llojet e tjera të agrumeve (portokajtë dhe limonët), kur nevojitet.

Mbledhja e të dhënave

Ky studim është pjesërisht cilësor dhe pjesërisht sasior. Kjo mundëson që të kuptohet më mirë statusi dhe dinamikat e zinxhirit të produktit përkatës. Studimi kombinon analizën e të dhënave të mbledhura dytësore dhe parësore. Për çështje/tregues të ndryshëm, analiza është bazuar në të dhënat dytësore (duke përfshirë të dhënat sektoriale/strukturore).

Të dhënat dytësore janë marrë nga MBZHR (Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural), INSTAT (Instituti i Statistikave), UNSTAT COMTRADE (për tregtinë ndërkombëtare), FAOSTAT (për prodhimin dhe konsumin) dhe EUROSTAT (për prodhimin dhe tregtinë ndërkombëtare) etj. Gjithashtu, është kryer një shqyrtim i studimeve dhe raporteve të tjera. Kufizimet e hasura janë se për disa tregues (lidhur me prodhimin vendas dhe tregtinë e brendshme) nuk ka statistika të disponueshme, ndërsa për disa të tjera nuk ka statistika të kohëve të fundit. Megjithatë, për tregtinë ndërkombëtare janë gjetur të dhënat më të fundit që edhe janë analizuar. Ndërkohë, në ato raste kur ka qenë e nevojshme dhe e mundur, janë mbledhur të dhëna nga vende (ose rajone) të tjera për qëllimet e një analize krahasuese.

Mbledhja e të dhënave parësore është realizuar nga intervistat e thelluara gjysmë të strukturuar me persona të mirëinformuar kyç që janë aktorë të zinxhirit të vlerës dhe ekspertë të sektorit. Për të identifikuar aktorët dhe ekspertët kryesorë për çdo zinxhir vlere për intervistat e gjysmë-

strukturuara (pjesë e studimit cilësor parësor) u përdor një anketim me teknikë kampionimi "snowball" (ortek bore). Intervistat e thelluara me aktorët kyç të informuar (së bashku me studimet e dokumentacionit në dispozicion) mundësuan të kuptuarin e përditësuar të modeleve kryesore dhe të hallkave kyçe të zinxhirit të vlerës. Në kontekstin e burimeve dhe kohës së kufizuar në dispozicion, u kryen vetëm një numër i kufizuar intervistash.

Analiza e të dhënave


Në lidhje me analizën e të dhënave/informacioneve, të dhënat statistikore dytësore i janë nënshtruar një analize standarde përshkruese, duke përfshirë tabelat dhe grafikët që tregojnë trendet statistikore apo historike. Është kryer edhe krahasimi i trendeve të prodhimit dhe konsumit me ato në botë, në Evropë dhe në disa raste me vendet fqinje, kur kjo ishte e nevojshme. Për sa i përket intervistave me ekspertë/aktorë të ZV-së, shënimet janë analizuar duke përdorur teknikat e analizës cilësore, me qëllimin për të përmbledhur çështjet më të rëndësishme dhe më interesante të përmendura në intervista. Analiza e zinxhirit të vlerës është përdorur si kuadër i përgjithshëm për analizën e strukturës së zinxhirit të vlerës (produktet, financat dhe informacionet) dhe për analizën e flukseve.

3. TENDENCAT DHE PRESPEKTIVAT E SEKTORIT TË AGRUMEVE

3.1. PRODHIMI PARËSOR

Shqipëria ka një traditë të konsoliduar në prodhimin e agrumeve (përkatësisht portokall, limon dhe mandarinë), prodhimi i të cilave është i përqendruar në zonat bregdetare. Ndër agrumet, mandarinat (në përgjithësi shumica e familjeve shqiptare njohin vetëm një term – përkatësisht “mandarina”, dhe për këtë arsye gjatë gjithë raportit përdoret vetëm ky term), janë lloji më dominues dhe me rritjen më të shpejtë (përbëjnë rreth 2/3 e sasisë së prodhimit të agrumeve).

Figura 1: Prodhimi i agrumeve sipas llojeve në vitin 2016 (tonë dhe %)



Burimi: INSTAT (2017)

Portokalli

Sipërfaqet e kultivuara me portokall kanë pasur një trend rënës. Megjithatë, përgjatë viteve ka pasur një rritje të prodhimit të portokallit, nga më pak se 7000 tonë në vitin 2010 në më shumë se 10 000 tonë në vitin 2016 – rritje kjo e nxitur nga shtimi i rendimentit (Tabela 1).

Tabela 1: Tendencat e prodhimit të portokallit në Shqipëri

Portokall	2010	2014	2015	2016
Tonë	6,631	4,120	8,347	10,063
Ha	370	222	223	209
Tonë/Ha	18	19	37	48

Burimi: FAOSTAT (2018)

Limonat

Prodhimi dhe sipërfaqet e kultivuara me limonë kanë pësuar një rritje të vazhdueshme gjatë viteve të fundit: nga 700 tonë dhe 70 Ha në vitin 2005 në përkatësisht 3607 tonë dhe 530 hektarë në vitin 2016 (Tabela 2).

Tabela 2: Tendencat e prodhimit të limonit në Shqipëri

Limoni	2005	2010	2014	2015	2016
Tonë	700	1,637	2,933	2,613	3,607
Ha	70	194	350	430	530
Tonë/Ha	10	8	8	6	7

Burimi: FAOSTAT (2018)

Mandarinat

Prodhimi i mandarinave është rritur ndjeshëm këto vitet e fundit: nga më pak se 100 Ha ose më pak se 1000 tonë në vitin 2005, në 26 000 tonë në vitin 2016 (dhe mbi 30 000 sipas intervistave). Kjo rritje prodhimi vjen si rezultat i kombinimit të rritjes së vazhdueshme si në sipërfaqet e kultivuara, ashtu dhe në rendiment.

Tabela 3: Tendencat e prodhimit të mandarinës në Shqipëri

Mandarinë	2005	2010	2014	2015	2016
Tonë	900	5,037	13,904	17,014	26,104
Ha	100	271	491	628	723
Tonë/Ha	9	19	28	27	36

Burimi: FAOSTAT (2018)

Pavarësisht trendeve të rritjes së fortë të prodhimit në Shqipëri, prodhimi i mandarinës është ende i papërfillshëm krahasuar me atë në BE.

Tabela 4: Tendencat e prodhimit të mandarinës në botë (000 tonë)

Shteti	2005	2010	2014	2015	2016
Shqipëri	1	5	14	17	26
Mali i Zi	:	2	3	4	4
BE	2,825	3,278	3,333	4,691	3,892
Bota	24,002	23,955	30,552	32,969	32,793

Burimi: FAOSTAT (2018)

Rendimenti i prodhimit të mandarinës në Shqipëri (36 tonë/ha) ka qenë më i lartë krahasuar me rendimentin mesatar botëror dhe atë në BE – duke dëshmuar kështu për një nënsektor me performancë të lartë (në shumë prej nënsektorëve agrorshqimorë, Shqipëria mbetet pas BE-së për sa i përket rendimentit).


Tabela 5: Tendencat e rendimentit të mandarinës në botë (Tonë/Ha)

Shteti	2000	2005	2010	2014	2015	2016
Shqipëri	:	9	19	28	27	36
Mali i Zi	:	:	17	23	23	24
BE	16	17	19	20	19	18
Bota	11	12	11	12	13	13
Evropë	16	17	19	20	19	18
Evropa Jugore	16	17	19	20	19	18
Evropa Perëndimore	12	13	14	20	13	18

Burimi: FAOSTAT (2018)

Shpërndarja rajonale

Prodhimi i mandarinave është mjaft i përqendruar në rajonin e Vlorës. Në qarkun e Vlorës dhe Fierit ka disa qindra fermerë me orientim të plotë ose të pjesshëm tregu që ndodhen kryesisht në Xarrë, Mursi dhe Konispol, shumë pranë kufirit me Greqinë – këto zona kanë kushte veçanërisht të favorshme për rritjen e agrumeve; në veçanti, zona ofron burime të bollshme ujore. Në këtë zonë agrumet janë kultivuar prej kohësh.

Figura 2: Shpërndarja e prodhimit të agrumeve sipas qarkut (2016)

Burimi: INSTAT (2017)


Tabela 6: Shpërndarja e prodhimit të agrumeve nëpër qarqe sipas llojit (2016)

Qarku	Portokall	Limona	Mandarina
Vlorë	2,020	517	20,842
Fier	4,004	1,340	1,831
Berat	887	377	1,552
Tiranë	551	335	488
Durrës	752	482	456
Elbasan	1,493	451	383
Lezhë	266	83	250
Të tjera (Shkodër, Gjirokastër)	90	23	301
Totali	10,063	3,607	26,104

Burimi: INSTAT (2017)


3.2. TENDENCAT E TREGTISË NDËRKOMBËTARE

Importi i portokajve mbetet i lartë – ndryshe nga frutat e tjera kryesore prodhimi vendas i tyre nuk është rritur me të njëjtin ritëm, duke lënë rrjedhimisht vend për importe. Për sa i përket eksporteve, ato janë të papërfillshme ose inekzistente.

Figura 3: Dinamikat e importit të portokajve në Shqipëri

Burimi: UNSTAT Comtrade (2018)


Ndryshe nga portokajtë, importi i mandarinave është karakterizuar nga një tkurrje e fortë si rezultat i rritjes së prodhimit vendas (që ka kontribuar pjesërisht në zëvendësimin e importeve dhe ka shkuar pjesërisht për eksporte).

Figura 4: Dinamikat e importit të mandarinave në Shqipëri

Burimi: UNSTAT Comtrade (2018)

Importet kryhen më së shumti gjatë 2-3 muajve të parë të vitit, duke pasur parasysh se në vendet fqinje vazhdon sezoni i prodhimit të tyre (p.sh. në Greqi dhe Itali) (për shkak të ekzistencës së varieteteve dhe kushteve të ndryshme të ruajtjes).

Siç u përmend më sipër, eksporti i tangerinave është rritur në mënyrë eksponenciale. Kryesisht vjelja dhe eksporti i tangerinave kryhet gjatë muajve nëntor-dhjetor.

Figura 5: Dinamikat e eksportit të mandarinave nga Shqipëria

Burimi: UNSTAT Comtrade (2018)

Bilanci tregtar për të gjithë kategorinë e agrumeve është duke u përmirësuar, megjithatë deficitit tregtar mbetet i lartë (Tabela 7).

Tabela 7: Totali i importit dhe eksportit të agrumeve nga Shqipëria (HS 0805)

Viti	Eksporte			Importe			Eksport/ Import	Eksport/ Import
	000 USD	Tonë	Çmimi	000 USD	Tonë	Çmimi	Vlera	Sasi
2000	:	:	:	6,966	27,404	0,25	:	:
2005	:	:	:	14,171	28,921	0,49	:	:
2010	41	93	0,43	21,805	34,896	0,62	0,2%	0,3%
2014	1,056	3,284	0,32	16,842	29,314	0,57	6,3%	11,2%
2015	1,928	5,880	0,33	10,110	20,641	0,49	19,1%	28,5%
2016	2,656	8,066	0,33	12,256	24,713	0,50	21,7%	32,6%

Burimi: UNSTAT Comtrade (2018)

Për sa i përket mandarinave, që prej vitit 2015 Shqipëria ka arritur një bilanc tregtar pozitiv që është përmirësuar në vitet në vijim dhe pritet të ketë rritje të mëtejshme pas hyrjes në prodhim të mandarinave të mbjella rishtas në vitet në vazhdim.

Tabela 8: Bilanci tregtar i mandarinave në Shqipëri

Viti	Eksporte			Importe			Eksport/ Import	Eksport/ Import
	000 USD	Tonë	Çmimi	000 USD	Tonë	Çmimi	Vlera	Sasi
2000	:	:	:	:	:	:	:	:
2005	:	:	:	:	10700	:	:	:
2010	12	45	0,27	6596	10411	0,63	0,2%	0,4%
2014	1020	3227	0,32	4277	7374	0,58	23,9%	43,8%
2015	1910	5843	0,33	2197	4544	0,48	86,9%	128,6%
2016	2450	7783	0,31	1564	3241	0,48	156,7%	240,1%

Burimi: UNSTAT Comtrade (2018)

Importi i portokajve mbetet i lartë (arrin në rreth 10 milionë USD) ashtu si edhe deficitit tregtar – duke nënkuptuar kështu potencial për zëvendësimin e importeve.

Tabela 9: Importi dhe eksporti i portokajve nga Shqipëria

Viti	Eksporte			Importe			Eksport/ Import	Eksport/ Import
	000 USD	Tonë	Çmimi	000 USD	Tonë	Çmimi	Vlera	Sasi
2000	:	:	:	4,316	17,850	0,2	:	:
2005	:	:	:	7,155	15,788	0,5	:	:
2010	9,9	5,8	1,7	13,156	22,083	0,6	0,08%	0,03%
2014	:	:	:	11,223	20,343	0,6	:	:
2015	6,0	16,1	0,4	6,019	13,361	0,5	0,10%	0,12%
2016	12,0	22,9	0,5	8,614	18,519	0,5	0,14%	0,12%

Burimi: UNSTAT Comtrade (2018)

Gjithashtu, edhe importi i limonëve (në ngjashmëri me portokajtë) mbetet i lartë (duke arritur në rreth 2 milionë USD) ashtu si edhe deficitit tregtar – duke nënkuptuar kështu potencial për zëvendësimin e importeve.


Tabela 10: Importi dhe eksporti i limonëve nga Shqipëria

Viti	Eksporte			Importe			Eksport/ Import Vlera	Eksport/ Import Sasi
	000 USD	Tonë	Çmimi	000 USD	Tonë	Çmimi		
2000	:	:	:	473	1,343	0,4	:	:
2005	:	:	:	1,412	2,268	0,6	:	:
2010	5,9	12,1	0,5	1,898	2,180	0,9	0,31%	0,55%
2014	1,4	3,2	0,4	1,163	1,351	0,9	0,12%	0,24%
2015	:	:	:	1,784	2,553	0,7	:	:
2016	59,8	42,9	1,4	1,961	2,759	0,7	3,05%	1,55%

Burimi: UNSTAT Comtrade (2018)

Figura 6 në vijim tregon dinamikën mujore të importit të mandarinave në vitin 2016.

Figura 6: Importi mujor i mandarinave në Shqipëri në vitin 2016 (tonë)



Burimi: EUROSTAT (2018)

Kosova është partneri kryesor i eksportit, e cila zë rreth 80% të totalit të eksporteve të agrumeve në përgjithësi, dhe mandarinave/tangerinave në veçanti. Një pjesë e produkteve që eksportohen në Kosovë, rieksportohen më vonë në vende të tjera të rajonit.

Tabela 11: Eksportet e agrumeve sipas shtetit partner, 2017

Agrumet	Jan	Nën	Dhje
Kosovë	80%	77%	78%
Totali (tonë)	402	3,483	5,675

Burimi: EUROSTAT (2018)

Agrumet importohen kryesisht nga Greqia, e pasuar nga Italia dhe Turqia.

Tabela 12: Importet e agrumeve sipas vendeve, 2017

Agrumet	Jan	Shku	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nën	Dhje
Greqi	72%	87%	90%	79%	60%	47%	46%	47%	48%	23%	59%	74%
Itali	27%	10%	4%	8%	15%	10%	0%	0%	2%	46%	2%	11%
Turqi	0%	3%	4%	11%	18%	15%	15%	0%	18%	28%	35%	14%
Totali (tonë)	2,960	3,478	3,284	2,211	954	725	679	836	619	1,121	781	2,132

Burimi: EUROSTAT (2018)

3.3. TREGU

3.3.1. Tregu ndërkombëtar

Shqipëria ka një bilanc tregtar negativ për agrumet. Megjithatë trendi i eksportit të këtij produkti është mbresëlënës - me një rritje vjetore prej 47% nga viti 2013 deri në 2017, pavarësisht një rënieje në vitin 2017 krahasuar me vitin 2016 (Tabela 12).

Tabela 12: Performanca e eksportit të agrumeve

Emërtimi i produktit	Vlera e eksportuar në emërtimin e produktit 2017 (000 USD)	Bilanci tregtar 2017 (000 USD)	Vlera e rritjes vjetore midis viteve 2013-17 (%)	Vlera e rritjes vjetore midis viteve 2016-17 (%)	Rritja vjetore e importeve botërore 2012-2016 (%)	Renditja në eksportet botërore
Të gjitha produktet	2,261,556	-3,564,766	-3	-7	-3	128
Produktet bujqësore	236,900	-764,546				
Agrumet	2,478	-7,577	47	-7	2	66

Burimi: Qendra Ndërkombëtare e Tregtisë. <https://www.trademap.org>

Eksporti i agrumeve/mandarinave ndodh në kushtet e kërkesës ndërkombëtare në rritje për këto produkte. Shqipëria renditet e 66-ta për eksportin botëror të agrumeve. Megjithatë, vlen për t'u theksuar se kërkesa e vendeve importuese aktuale është në rënie, që do të thotë se Shqipëria duhet të riorientojë destinacionet e saj të eksportit.

3.3.2 Tregu i brendshëm

Përçindja që zë importi në konsumin vendas mbetet e lartë, pavarësisht përmirësimit gjatë viteve të fundit. Eksportet janë rritur, nga pothuajse inekzistente në 30% të prodhimit, në rastin e mandarinave.

Tabela 14: Bilanci i ofertës së mandarinave në Shqipëri (000 tonë)

Kategoria	2005	2010	2015	2016
Prodhimi	0,9	5,0	13,9	26,1
Importi	10,7	10,4	4,5	3,2
Eksporti	:	0,04	5,8	7,8
Oferta	11,6	15,3	12,6	21,5
Importi/ofertë	92,2%	67,7%	35,7%	14,9%
Eksporti/prodhimi	:	0,8%	41,7%	30,0%

Burimi: Përgatitur nga autorët, përlogaritje bazuar në të dhënat nga INSTAT, EUROSTAT dhe UNSTAT (2018)

Pas kalimit në ekonominë e tregut në fillim të viteve 1990, kërkesa e konsumatorëve shqiptarë për fruta u rrit ndjeshëm. Si rezultat i liberalizimit të tregut dhe kombinimit të kapaciteteve të zgjeruara të shitjes me pakicë, prodhimit dhe pasvjeljes/magazinimit si dhe rritjes së të ardhurave dhe standardit të jetesës së popullsisë shqiptare, konsumi i frutave në fund të viteve 2000 është më shumë se dyfishuar, në krahasim me periudhën para tranzicionit

Konsumi i portokajve dhe mandarinave në Shqipëri është më i ulët se konsumi mesatar botëror për frymë, i cili në vitin 2013 ishte rreth 24,6 kg/frymë, ndërsa në Shqipëri ishte 12,6 kg/frymë. Mali i Zi ka konsumin më të lartë të portokajve dhe mandarinave për frymë nga të gjitha vendet e Ballkanit, ndërsa Serbia ka konsumin më të ulët për frymë.

Tabela 15: Konsumi i portokajve dhe mandarinave në Shqipëri dhe në vende dhe rajone të tjera (Kg/frymë)

Shteti	2000	2005	2010	2011	2012	2013
Shqipëri	8,7	10,7	14,8	13,7	13,4	12,6
Mali i Zi	:	:	26,3	27,9	28,1	28,9
Serbi	:	:	8,9	9,8	8,9	9,0
Maqedoni	4,1	9,7	14,7	12,4	12,0	11,8
BE	11,4	12,0	12,5	13,3	12,6	12,4
Evropë	22,7	27,8	27,0	29,5	29,5	30,3
Bota	16,5	21,2	21,5	23,8	23,9	24,6
Evropa Lindore	4,0	7,1	8,3	9,1	9,7	10,5
Evropa Jugore	32,2	33,9	34,1	32,9	28,8	29,3
Evropa Perëndimore	20,4	24,6	23,8	31,6	32,7	33,4

Burimi: FAOSTAT (2018)

Shënim: shifrat më të fundit në dispozicion për konsumin datojnë në vitin 2013 – megjithëse nuk janë përditësuar, mund të merren në konsideratë si udhëzues, meqenëse në përgjithësi ndryshimi i modelit të konsumit me kalimin e kohës është i ngadaltë.

Origjina e prodhimit duket se është një faktor i rëndësishëm për shumicën e konsumatorëve shqiptarë. Sipas studimeve të ndryshme, shumica e konsumatorëve i zgjedhin produktet e tyre nga origjina (vendase kundrejt importeve). Studimet e mëparshme kanë treguar se ekziston një preferencë e qartë për frutat vendase, duke përfshirë kryesisht mandarinat dhe limonat, për të cilat ekziston gjithashtu një preferencë që lidhet me territorin specifik brenda Shqipërisë, i cili

paraqet një potencial për investime lidhur me marketingun¹. Shumica e konsumatorëve shqiptarë i konsiderojnë produktet organike si më të sigurta dhe më të shëndetshme se produktet e tjera (tradicionale). Megjithatë, shumica e konsumatorëve nuk kanë njohuri për certifikimin organik (kërkesat). Konsumatorët shqiptarë kanë një mungesë të përgjithshme informacioni për atë çka quhet ushqim organik. Tregu për ushqimin organik në Shqipëri është ende i vogël, por preferenca e konsumatorëve për ushqim organik paraqet një potencial për zhvillimin e tregut. Perceptimet e një lidhjeje ndërmjet ushqimeve organike dhe problemeve me shëndetin paraqesin një avantazh të rëndësishëm për prodhimin e ushqimeve organike dhe mund të kapitalizohen në promovimin e tregtimit të tyre dhe në nxitjen e investimeve nga prodhuesit/tregtarët².

1 Imami, D., Skreli, E. (2013) Consumer preferences for regional/local products in Albania, technical report prepared for FAO


2 Imami, D., Skreli, E., Zhllima, E., & Chan, C. (2017). Consumer attitudes towards organic food in the Western Balkans- the case of Albania. ECONOMIA AGRO-ALIMENTARE.

4. STRUKTURA E ZINXIRIT TË VLERËS DHE AKTORËT KRYESORË

4.1. STRUKTURA E ZINXIRIT TË VLERËS DHE PROFILI I AKTORËVE

Figura 7 identifikon në hartë aktorët e zinxhirit të vlerës së mandarinave dhe kanalet kryesore përmes së cilëve frutat qarkullojnë nga fermerët te konsumatori fundor.

Figura 7: Skema e zinxhirit të vlerës së mandarinave



Burimi: Përgatitur nga autorët

Tre aktorët kryesorë në zinxhirin e vlerës së agrumeve janë fermerët, konsoliduesit dhe shitësit me shumicë. Kategoria e fundit përbëhet nga tregtarët e mesëm dhe tregtarët e mëdhenj të shitjes me shumicë. Përshkrimi i profileve të aktorëve kryesorë (i përmbledhur më poshtë) ndiqet nga përshkrimi i flukseve në zinxhirin e vlerës dhe koordinimit të këtij zinxhiri.

Fermerët

Ndërkohë që prodhimi jo për treg i mandarinave të kopshtit nuk është marrë në analizë, fermerët prodhues të mandarinave për treg mund të përfaqësohen nga dy grupe fermerësh, përkatësisht fermerët me orientim të plotë tregu dhe ata me orientim të pjesshëm.

Fermerët me orientim të pjesshëm tregu janë kultivuesit e vegjël që kanë sipërfaqe me drufrutorë përgjithësisht më të vogla se 0,5 ha dhe përdorin investime të kufizuara në teknologjinë e prodhimit. Këta fermerë janë kryesisht të shpërndarë në rrethet e Vlorës, Fierit, Lushnjës, Elbasanit dhe Beratit. Fermerët me orientim tregu të mandarinave përbëhen nga një grup fermerësh të cilët kanë plantacione me sipërfaqe mbi 0,5 ha (Tabela 16) dhe që janë të përqendruar në bashkinë e Konispolit. Këta fermerë përdorin teknologji dhe praktika moderne prodhimi që synojnë maksimizimin e prodhimit.

Tabela 16: Fermat e mandarinave me orientim tregu, për 2017

Kategoritë e fermave	Numri	%
6 deri në 10 dn	22	43,1
11 deri në 20 dn	7	13,7
21 deri në 50 dn	10	19,6
mbi 51 dn	3	5,9
Totali	42	100

Burimi: Përgatitur nga autorët. (Të dhënat bruto nga MBZHR)

Konsoliduesit

Konsoliduesit në tregun e mandarinave që operojnë me magazina ambalazhimi në bashkinë e Konispolit përbëjnë një pikë kyçe për zinxhirin e vlerës së mandarinës. Pjesa e konsoliduesve në tregun e mandarinës po bëhet mjaft konkurruese; raportohet se në zonën e Konispolit operojnë 6 konsolidues. Kapaciteti i tyre i magazinimit është i pamjaftueshëm (duke marrë gjithashtu në konsideratë rritjen e shpejtë të prodhimit).

Shitësit e mëdhenj me shumicë

Aktualisht, numri i operatorëve të kësaj kategorie që merren me tregtinë e mandarinave është i kufizuar. Ky grup operatorësh prirën të investojnë në asete të mëdha dhe moderne (magazina e dhoma ftohjeje të mëdha, linja seleksionimi, pastrimi dhe paketimi, pajisje të mekanizuara ngarkimi dhe shkarkimi), të kenë marrëdhënie më të qëndrueshme me furnitorët dhe me blerësit ndërkombëtarë në bazë të interesave si dhe të planifikojnë për investime të reja.

Furnizuesit e ndërmjetëm (tregu i brendshëm)

Furnizuesit e ndërmjetëm janë tregtarë të vegjël të cilët blejnë nga shitës me shumicë apo fermerë të ndryshëm dhe plotësojnë nevojat e njërive të vogla të shitjes me pakicë që dominojnë tregtinë me pakicë të frutave dhe perimeve (gamë e gjerë produktesh, sasi më të vogla dhe çmime më të ulëta për prodhimet vendase të frutave dhe perimeve si rezultat i kanaleve më të drejtpërdrejta).

4.2. FLUKSET NË ZINXHIRIN E VLERËS DHE KOORDINIMI I KËTIJ ZINXHIRI

Flukset e produktit, të informacionit dhe ato financiare

Flukset e produktit. Figura 7 identifikon në mënyrë skematike zinxhirin e vlerës së mandarinave në Shqipëri. Tregtia e mandarinave në Shqipëri mund të ndahet në tre kanale kryesore: kanali i brendshëm gjysmë komercial, kanali i brendshëm komercial dhe kanali me orientim eksporti.

Prodhuesit e sektorit me orientim gjysmë komercial e shesin prodhimin drejtpërdrejt ose nëpërmjet tregtarëve të ndërmjetëm të shumicës të shitësit me pakicë të qyteteve në afërsi. Për sa u përket përmasës, parashikohet që ky kanal do të jetë i qëndrueshëm për të ardhmen e afërt. Në rastin e kanalit të brendshëm me orientim komercial, fermerët e shesin prodhimin drejtpërdrejt ose nëpërmjet konsoliduesve kryesisht të shitësit e ndërjetëm me shumicë të cilët operojnë në tregjet kryesore me shumicë të Lushnjës dhe Tiranës. Tregtarët e ndërmjetëm të shitjes me shumicë e shesin prodhimin të shitësit me pakicë. Një kanal mjaft interesant po bëhet edhe sektori i ri i eksportit me orientim tregtar. Në këtë rast, fermerët e shesin prodhimin të konsoliduesit (të cilët merren me eksport) ose drejtpërdrejt të tregtarët e mëdhenj të shitjes me shumicë që kanë tashmë marrëdhënie të konsoliduara me blerësit në vendet e Evropës apo të rajonit. Tregu kryesor i eksportit të mandarinave është Kosova. Zakonisht tregtarët e Kosovës i blejnë produktet në mjediset e konsoliduesve vendas dhe i transportojnë ato me kamionët e tyre.

Flukset e informacionit. Konsoliduesit në sektorin e mandarinës kanë filluar të informojnë fermerët në lidhje me kultivarët që duhet të mbjellin, në mënyrë që të garantohet një furnizim i qëndrueshëm i tregut (shihni koordinimin e zinxhirit të vlerës).

Flukset financiare. Marrëdhëniet financiare mbizotëruese midis fermerit dhe konsoliduesit të mandarinave janë pagesat e menjëhershme ose afatshkurtra, shpesh me para në dorë. Pagesa e fermerëve mund të kryhet me anë të kursimeve (ose kredive) të konsoliduesve.

Koordinimi i zinxhirit të vlerës

Konsoliduesit po shndërrohen në një aktor kryesor në zinxhirin e vlerës së mandarinës (ashtu si edhe në zinxhirin e vlerës së mollës, që analizohet në një tjetër studim/raport). Në sektorin e mandarinave të udhëhequr nga konsoliduesit është vënë re një organizim i koordinuar. Disa konsolidues i kanë udhëzuar fermerët në lidhje me kultivarët më të kërkuar të mandarinave në tregun e eksportit dhe ç'është më e rëndësishme në lidhje me kombinimin e kultivarëve në mënyrë që të garantohet një furnizim i qëndrueshëm. Pjesa e konsoliduesve në tregun e mandarinës po bëhet mjaft konkurruese; në zonën e Konispolit operojnë 6 konsolidues sipas intervistave. Një konkurrencë e tillë pritët të nxisë krijimin e marrëdhënieve më të qëndrueshme me fermerët. Konsoliduesit vizionarë të cilët synojnë tregun e BE-së, e konsiderojnë tejet të rëndësishëm krijimin e marrëdhënieve të qëndrueshme me fermerët në mënyrë që të sigurojnë produkte cilësore.

5. PROCESET E TEKNOLOGJISË SË PRODHIMIT

Në tabelën e mëposhtme (17) tregohen komponentët kryesorë të kostos operative, ku përfshihet krasitja, plehërimi, trajtimi kimik, ujitja dhe vjelja.

Tabela 17: Kalendar i kostos së prodhimit të mandarinës

Llojet kryesore të shpenzimeve	Muajt												
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	
1. Krasitja dimërore dhe verore													
2. Plehra bazë dhe plotësuese													
3. Trajtimet kimike, spërkatja													
4. Ujitja													
5. Vjelja													

Burimi: Vlerësimi i ekspertëve, bazuar në shqyrtimet e dokumentacionit dhe intervistat

Vjelja e agrumeve kryhet gjatë muajve tetor-dhjetor (në varësi të llojit të produktit).

Tabela 18: Kalendar i vjeljes sipas llojit të produktit

Lloji i produktit	Muajt												
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	
Limon													
Mandarinë													
Portokall													

Burimi: Vlerësimi i ekspertëve, bazuar në shqyrtimet e dokumentacionit dhe intervistat

Sic mund të shihet nga informacioni/tabelat më lart, ekziston një diferencë kohore ndërmjet momentit që kryhen shpenzimet dhe shitjet. Për këtë arsye, ekziston një hapësirë kohore për kredi afatshkurtra, të cilat mund të mbulohen nga bankat.

6. ANALIZA SWOT DHE NEVOJAT PËR FINANCIM

6.1. STRATEGJIA BAZUAR PËR ANALIZËN SWOT

Strategjia e mëposhtme bazuar në analizën SWOT është kryer me qëllim identifikimin e mundësive për financim në sektorin e mandarinës.

Tabela 19: Sektori i mandarinës: Strategjia për analizën SWOT

	PIKAT E FORTA (S) (+)	PIKAT E DOBËTA (W) (-)
	Rritja e numrit të fermerëve të mandarinës me orientim tregu në Shqipërinë e jugut	Struktura e papërshtatshme të kultivarëve të mandarinës
	Përdorimi i teknologjisë moderne nga kultivuesit me orientim tregu	Kapaciteti i pamjaftueshëm i magazinimit
	Mirëfunksionimi i kanaleve të eksportit	Mungesa e linjave të seleksionimit, klasifikimit, paketimit dhe etiketimit, që rezulton në çmime të ulta
		Mungesa e mekanizimit në nivelin e magazinimit
MUNDËSITË (O) (+)	STRATEGJIA PËR S (+) / O (+)	STRATEGJIA PËR W (-) / O (+)
Mosshfrytëzimi i shumë sipërfaqeve të përshtatshme për kultivimin e mandarinës	Mbështetja e mbjelljes së kultivarëve të preferuar të mandarinës në treg	
Mosplotësimi i kërkesës së brendshme dhe preferencës së konsumatorëve për prodhimin vendas të mandarinës	Mbështetja e investimeve në linjat e seleksionimit, klasifikimit, paketimit dhe etiketimit, që rezulton në uljen e papërshtatshme të çmimit	
Mundësitë e reja të eksportit		Mbështetja e investimeve në kapacitetet e magazinimit
KËRCËNIMET (T) (-)	STRATEGJIA PËR S (+) / T (-)	STRATEGJIA PËR W (-) / T (-)
Konkurrenca e fortë nga Greqia dhe Italia fqinje	Mbështetja e teknologjisë së ushqyerit të bimëve për fermerët me orientim tregu për prodhimin me kosto të ulët të produkteve frutore cilësore	Mbështetja e mekanizimit në nivelin e magazinimit për reduktimin e kostove

6.2. NEVOJAT PËR FINANCIM

6.2.1. Tendencat për investime dhe nevojat për financim

Tendencat për investime

Kohët e fundit në Shqipëri është përhapur ngritja e plantacioneve me agrume. Pavarësisht se Fieri mban vendin e parë për prodhimin e agrumeve, Vlora është rajoni më i rëndësishëm për sa i përket prodhimit me orientim tregtar. Në rajonin e Vlorës, Konispoli është qendra më e rëndësishme e prodhimit të agrumeve, veçanërisht të mandarinës. Fermerët e kësaj zone kanë ngritur plantacione model me agrume duke përdorur teknologji moderne. Sipas intervistave vihet

re një trend dinamik i plantacioneve të agrumeve, veçanërisht atyre të mandarinës. Duke pasur parasysh këtë, edhe fermerët e Fierit, Elbasanit, Beratit dhe rajoneve të tjera e konsiderojnë me përfitim investimin në agrume me orientim tregu. Në nivel përtej fermës, konsoliduesit vendas kanë investuar në kapacitete magazinimi. Disa investime në linjat e tregtimit dhe në mjedise frigoriferike janë kryer vetëm tek tregtarët e mëdhenj të shitjes me shumicë, të cilët tregtojnë – midis të tjerash – edhe agrume.

Nevojat e financimit për investime

Duke u mbështetur në strategjinë e bazuar në analizën SWOT dhe tendencat e investimeve, nevojat e financimit për investime janë përmbledhur në tabelën 20.

Tabela 20: Nevojat e financimit për investime në sektorin e mandarinës

Lloji i investimit	Fermerët	Konsoliduesit	Shitësit me shumicë
Mbështetja e mbjelljes së kultivarëve të preferuar të mandarinës në treg			
Mbështetja e teknologjive të të ushqyerit të bimëve për fermerët me orientim tregu			
Mbështetja e investimeve në kapacitete magazinimi dhe frigoriferike			
Mbështetja e mekanizimit në ambientet e magazinimit (mjete ngarkimi, transport në paleta, etj.)			
Mbështetja e investimeve në linjat e seleksionimit, klasifikimit, paketimit dhe etiketimit, e qëllim që të përmirësohet marketingu i produktit dhe të merret një çmim më i mirë			
Certifikimi Global Gap			

Trendet e fundit dhe vlerësimit e ekspertëve konfirmojnë se mbjellja e agrumeve, sidomos e mandarinave është një aktivitet bujqësor fitimprurës - në rastin më të mirë, duke marrë parasysh një rendiment prej 50 Ton/ha dhe një çmim prodhimi në fermë prej 45 lekë/kg, të ardhurat bruto për ha janë 2,2 milionë lekë, duke përbërë kështu me shumë mundësi një nga aktivitetet bujqësore më fitim-prurëse në Shqipëri. Për këtë arsye, ngritja e plantacioneve të reja me agrume/mandarina duke përdorur kultivarët e kërkuar në treg, sidomos në tregun e eksporteve, paraqesin një mundësi për institucionet financiare. Sipas vlerësimeve, prodhimi i mandarinës në Konispol arrin në 30 mijë Ton dhe brenda pak viteve pritet të shkojë 50 deri në 60 mijë Ton. Pra, mbështetja e tendencës aktuale të plantacioneve përbën një "mundësi të artë" për institucionet financiare. Është e këshillueshme që në këtë rast, institucionet financiare të marrin në konsideratë projekte të plota investimesh që kuptojnë mbjelljen e pemëve, sistemin i ujitjes me pika dhe të ushqyerit e bimëve përmes ujitjes dhe investimet e tjera përkatëse. Gjithashtu, mund të merret në konsideratë mbështetja e këtyre projekteve të plota edhe në plantacionet ekzistuese, të cilat nuk janë të pajisura me një sistem ujitjeje/plehërimi.

Konsoliduesit dhe shitësit me shumicë që merren me eksport kanë investuar në ambiente magazinimi, por ato nuk janë të mjaftueshme; me shumë gjasë kjo është nevoja më e ngutshme për investim. Megjithatë mjediset frigoriferike nuk konsiderohen një nevojë e ngutshme investimi, ekspertët mbështetnin mendimin se në rastin e agrumeve/mandarinave kjo është e domosdoshme për dy arsye midis të tjerash: (i) menaxhimin e pikut të ofertës (ii) konsolidimin e ofertës për të plotësuar kërkesën e eksportit. Teknikisht, mandarinat mund të ruhen nga katër deri në gjashtë javë.

Kapacitetet e ambalazhimit përbëjnë gjithashtu një mundësi të mirëfilltë financimi për institucionet financiare. Pavarësisht hezitimit të disa prej konsoliduesve - aktualisht, mandarinat e eksportuara në Kosovë janë zakonisht të paklasifikuara sipas cilësisë apo madhësisë - konsoliduesit që merren me eksport në zonën e Konsipolit dhe shitësit me shumicë po planifikojnë të investojnë në kapacitete ambalazhimi (linja seleksionimi, klasifikimi dhe paketimi). Këto investime janë veçanërisht të nevojshme në rastet kur synohen tregje më tërheqëse.

Kutia 1: Skemat publike të mbështetjes për bujqësinë shqiptare.

Ka dy skema kryesore publike të mbështetjes për bujqësinë shqiptare, përkatësisht Skemat Kombëtare të Mbështetjes (SKM) që jepen çdo vit dhe mbështetja nga BE, si Programi për Zhvillimin Rural, IPARD. Ndërkohë që ky i fundit synon të rrisë konkurrueshmërinë dhe të zbatojë standardet e BE-së (siguria, cilësia dhe mjedisi) dhe synon bizneset më konkurruese, SKM ka politika me shumë objektiva dhe një shtrirje më të gjerë.

Objektivat dhe masat për SKM 2018 janë përmbledhur në vijim:

- Rritja e konkurrueshmërisë duke ofruar mbështetje për investime (mbjellje të pemëve të reja frutore, investime në marketing), mbështetja e teknologjive të inovacionit dhe certifikimit dhe siguracionit
- Formalizimi vertikal dhe horizontal dhe formalizimi i biznesit
- Diversifikimi i veprimtarive rurale.

Ndërkohë që SKM-të tradicionalisht kanë ofruar mbështetje për të përmbushur disa objektiva të politikës, duke përfshirë rritjen e konkurrueshmërisë, kohët e fundit është shtuar vëmendja për arritjen e standardeve të sigurisë së ushqimit, cilësisë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Skemat kombëtare të subvencionimit tradicionalisht kanë ndryshuar nga viti në vit (shpesh në mënyrë drastike). Buxheti i alokuar për SKM 2018 është 20 milion euro. Për mbështetjen për investime është e vlefshme edhe skema e ngjashme e politikave të granteve të pjesshme (të paktën 50% mbështetje publike).

Një program tjetër i rëndësishëm është programi i BE-së, IPARD - Programi i Masave për Zhvillimin Rural, i cili mundëson mbështetje për investime që synojnë përmirësimin e konkurrueshmërisë dhe përmbushjen e standardeve kombëtare dhe të BE-së nëpërmjet investimeve të bashkëfinancuara nëpërmjet një granti (p.sh. 50%, megjithatë vlera e saktë varet nga një sërë kriteresh). Për këtë program është miratuar një buxhet në formë granti prej 71 milionë euro nga KE dhe 24 milionë euro nga qeveria shqiptare (75% BE: 25% qeveria shqiptare), kështu që është i disponueshëm një grant për investime prej 94 milionë euro në nivel ferme dhe nivel përpunimi/marketingu gjatë periudhës 2014-2020.

6.2.2. Nevojat për financime për kapital qarkullues

Tendencat e financimeve për kapital qarkullues

Zakonisht, nevojat e financimit të kapitalit qarkullues të fermerëve dhe tregtarëve mbulohen nga të ardhurat e secilës prej palëve; pra marrja e një kredie afatshkurtër nuk është e zakonshme.


Nevojat për financime për kapital qarkullues

Ndërkohë që blerësit në sektorin e mandarinës kryesisht nuk kanë përdorur kreditë për të mbuluar nevojat afatshkurtra për kapital, struktura (konkurrese) e tregut në nivelin e konsoliduesve do t'i nxisë të konkurrojnë për fermerët furnizues. Një dimension kyç i kësaj marrëdhënieje është pagesa në kohë dhe si pasojë nevoja për të përfituar kredi afatshkurtra – gjë që përbën një mundësi të vlefshme financimi për institucionet financiare.

6.2.3. Financimi i zinxhirit të vlerës

Flukset e produktit, informacionit dhe ato financiare midis konsoliduesve dhe fermerëve vendas përbën potencial për zbatimin e financimit sipas qasjes së zinxhirit të vlerës. Figura 8 në vijim përmbledh mënyrën se si mund të organizohet financimi sipas qasjes së zinxhirit të vlerës.

Figura 8: Financimi i zinxhirit të vlerës për sektorin e agrumeve



Burimi: Përgatitur nga autorët

Struktura konkurruese e tregut në nivelin e konsoliduesve do t'i motivojë ata të krijojnë marrëdhënie më të ngushta me fermerët furnizues, duke përfshirë pagesën në kohë të tyre. Për t'i paguar fermerët në kohë, konsoliduesi mund të përdorë një kredi afatshkurtër nga një bankë tregtare për t'i transferuar pastaj paratë në llogarinë bankare të fermerit - transferimi i parave në llogaritë bankare të fermerëve është një fenomen i kohëve të fundit në Shqipëri. Pasi konsoliduesi e shet produktin, ai shlyen kredinë. Megjithatë, duhet theksuar se konsoliduesi mund t'i japë bankës informacione të rëndësishme për fermerët, duke përfshirë kohën e transferimit të parave në llogaritë bankare të fermerëve.

7. PËRFUNDIME

Shqipëria ka një traditë të konsoliduar në prodhimin e agrumeve (përkatësisht portokalle, limona dhe mandarina), prodhimi i të cilave është i përqendruar në zonat bregdetare. Kategoria e frutave që ka njohur rritjen më të madhe është ajo e agrumeve, veçanërisht e mandarinave, të cilat kanë pasur shumë sukses. Ndër agrumet, mandarinat janë produkti më dominues dhe me rritjen më të shpejtë (duke përbërë rreth 2/3 e sasisë së prodhimit të agrumeve).

Prodhimi i mandarinave është rritur ndjeshëm këto vitet e fundit: nga më pak se 100 Ha ose më pak se 1000 tonë në vitin 2005, në 30 000 tonë vitin e kaluar – prodhimi i limonëve dhe portokajve po rritet pothuajse me të njëjtin trend. Si rezultat, importi i mandarinave është karakterizuar nga një tkurrje e fortë si pasojë e rritjes së prodhimit vendas që ka kontribuar pjesërisht në zëvendësimin e importeve. Gjithashtu, rritje të konsiderueshme gjatë viteve të fundit ka pasur dhe eksporti i tyre.

Ndërkohë që Shqipëria ka një bilanc tregtar negativ për agrumet, trendi i eksportit të agrumeve / mandarinave është mbresëlënës - rritja vjetore e eksportit të këtij produkti nga viti 2013 deri në 2017 ka qenë 47%. Eksporti i agrumeve/mandarinave ndodh në kushtet e kërkesës ndërkombëtare në rritje për këtë produkt. Në nivel botëror, Shqipëria renditet e 66-ta për eksportin e agrumeve. Megjithatë, vlen për t'u theksuar se kërkesa e vendeve importuese të mandarinës shqiptare është në rënie, që do të thotë se Shqipëria duhet të riorientojë tregjet e synuara të eksportit.

Ky studim informon institucionet financiare dhe palë të tjera të interesuara për mbështetjen e sektorit të agrumeve për mundësitë kryesore për të financuar këtë sektor. Investime që duhet të merren në konsideratë në nivel ferme janë mbjellja e agrumeve/mandarinave duke përdorur kultivarë të kërkuar në treg, veçanërisht në tregun e eksportit duke zbatuar projekte të plota të investimeve (mbjellje, sistem ujitjeje me pika/plehërimi dhe investime të tjera përkatëse). Në nivelin e konsoliduesve/shitësve me shumicë, institucionet financiare mund të marrin në konsideratë mbështetjen për ambientet e magazinimit; me shumë gjasë kjo është nevoja më e ngutshme për investim. Ndonëse ambientet e ruajtjes në kushte frigoriferike nuk konsiderohen nevojë e ngutshme investimi, ekspertët mbështetnin mendimin se në rastin e agrumeve/mandarinave ajo është e domosdoshme. Mandarinat mund të ruhen nga katër deri në gjashtë javë. Kapacitetet e ambalazhimit përbëjnë gjithashtu një mundësi të mirëfilltë financimi për institucionet financiare. Konsoliduesit që punojnë me eksporte në zonën e Konispolit dhe shitësit me shumicë po planifikojnë të investojnë në kapacitete/infrastrukturë ambalazhimi (linja seleksionimi, klasifikimi dhe paketimi). Këto investime janë veçanërisht të nevojshme në rastet kur synohen tregje më fitim-prurëse.

Konsoliduesit po shndërrohen në liderët kryesorë të zinxhirit të vlerës së agrumeve/mandarinave. Gjithashtu, marrëdhëniet e krijuara me fermerët furnizues (që pritet të forcohen), përbëjnë potencial si për zhvillimin e produkteve financiare të tipit kapitali qarkullues afatshkurtër, dhe për financimin sipas qasjes së zinxhirit të vlerës.

Spektori i agrumeve konsiderohet si sektor me përparësi për qeverinë shqiptare - sektori është përfshirë në skemat e mbështetjes financiare publike. Politika aktuale e granteve të pjesëshme ka implikime të rëndësishme për institucionet financiare - ata kanë mundësinë për të financuar investimet për investimin 100% të shumës, nga e cila 50% mund të jetë kredi afatshkurtër (pjesa që duhet të rimbursohet nga granti pas kryerjes së investimit) dhe 50% kredi afatgjatë (pjesa që duhet të paguhet nga përfituesi).

8. REFERENCA

EUROSTAT (2018). Baza e të dhënave gjendet në <http://ec.europa.eu/eurostat>

FAOSTAT (2018). Baza e të dhënave gjendet në <http://www.fao.org/faostat/en/>?

Imami, D., & Skreli, E. (2013). Consumer preferences for regional/local products in Albania, technical report prepared for FAO

Imami, D., Skreli, E., Zhllima, E., & Chan, C. (2017). Qëndrimet e konsumatorëve ndaj ushqimit organik në Ballkanin Perëndimor-rasti i Shqipërisë. *Ekonomia agroushqimore*.

INSTAT (2017). Baza e të dhënave gjendet në www.instat.gov.al

Qendra Ndërkombëtare e Tregtisë (2018). <https://www.trademap.org>

UNSTAT (2018). Baza e të dhënave për tregtinë ndërkombëtare. <https://comtrade.un.org/data/>

Zhllima, E., Imami, D., & Merkaj, E. (2012). Food consumer trends in post socialist countries: the case of Albania. *Ekonomia agro-alimentare*.

Shënime:

Lined writing area consisting of 20 horizontal dashed lines for notes.



Tiranë, 2019